

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MIREQENIES SOCIALE DHE RINISE
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

KONTROLL LABORATORIK

I USHQIMIT

Niveli V i KSHK
(Pas të mesmes)

Kodi: A1-V-14

Miratoi:

.....

**Ky skeletkurrikul u hartua me mbështetjen e Projektit IPA 2010 për
Zhvillimin e Burimeve Njerëzore, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga
Organizata Ndërkombëtare e Punës.**



Tiranë, 2014

Përmbajtja:

- I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niv. V i KSHK.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.**
 1. Kërkesat e pranimi të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.
 2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimimit në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.
 3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimimit në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.
- III. Plani mësimor për profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 1 vit mësimor**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.**
- VII. Përshkruesit e moduleve profesionale.**

I. Qëllimet e arsimit profesional pas të mesmes në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit” niveli V i KSHK.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, është *“përgatitja e nxënësve me kompetencat profesionale të nevojshme për të kryer analizat laboratorike që garantojnë cilësinë dhe sigurinë ushqimore”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale në nivelin pas të mesëm, u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me këtë kualifikim profesional;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional, në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë ato/ata që:

- kanë mbaruar arsimin e mesëm profesional në drejtimin “Teknologji Ushqimore” niveli III te AP ose niveli V i KSHK;
- kanë mbaruar arsimin e mesëm, punojnë në industrinë ushqimore dhe janë të aftë të demonstrojnë aftësi të nivelit III te AP ose niveli V i KSHK, në drejtimin Teknologji ushqimore.
- janë të aftë nga pikëpamja shëndetësore për punë në sektorin e shërbimit laboratorik ushqimor;

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë kualifikim janë më të larta se kapacitetet reale të shkollave që e ofrojnë, atëherë MMSR përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat profesionale si më poshtë:

- Të zbatojë kuadrin ligjor në fushën e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore.
- Të zbatojë standarte zyrtare të miratuara sipas rregulloreve në fuqi dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e kontrollit të cilësisë e sigurisë ushqimore
- Të kryejë veprimtari menaxhuese dhe administruese në ambientet e laboratorit

- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë në një laborator ushqimor
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në punë, duke përdorur të gjitha mjetet mbrojtëse personale dhe të ambientit
- Të zbatojë procedurat e mbrojtjes së mjedisit nga mbetjet laboratorike.
- Të sigurojë kushtet mjedisore për kryerjen e analizave në laborator.
- Të zbatojë normat dhe standardet e cilësisë e saktësisë gjatë analizave dhe veprimeve në laboratorin ushqimor.
- Të zbatojë procedurat e dokumentimit të analizave laboratorike, sipas kërkesave të standartit për laboratorët ISO 17 025.,
- Të përgatisë paisjet laboratorike, solucionet, reagentët dhe të gjitha mjetet ndihmëse të nevojshme për fillimin e punës.
- Të përgatitë mostrat e produkteve ushqimore për të kryer analizat përkatëse.
- Të zbatojë planin e shërbimeve dhe mirëmbajtjes të paisjeve dhe mjeteve laboratorike.
- Të hartojë një plan për kërkesat për trajnime dhe njohjen me të rejat në fushën e kontrollit të ushqimit.
- Të zbatojë instruksionet teknike të paisjeve e procedurat teknike të operimit në laborator.
- Të përcaktojë treguesit organo-shqisore të produkteve ushqimore.
- Të kryejë matje të treguesve fizikë të produkteve ushqimore.
- Të kryejë analizat kimike të produkteve ushqimore.
- Të kryejë analizat mikrobiologjike të produkteve ushqimore.
- Të kryejë analizat e ujit të pijshëm.
- Të kryejë analizat e qumështit dhe të nënprodukteve të tij.
- Të kryejë analizat e mishit , nënprodukteve ,e peshkut.
- Të kryejë analizat e sheqerit dhe të nënprodukteve të tij.
- Të kryejë analizat e drithrave,miellrave dhe brumrave.
- Të kryejë analizat e pijeve alkoolike
- Të kryejë analizat e pijeve jo alkoolike.
- Të kryejë analizat e konservave te fruta - perimeve.
- Të kryejë analizat e yndyrnave.
- Të kryejë analizat e ushqimeve per kafshe.
- Të kryejë analizat e produkteve te veçanta (kafe,çaj i gjelbër,kakaos,vezës).
- Të llogarisë me saktësi rezultatet e analizave, duke përdorur aftësitë matematikore.
- Të kryejë pastrimin dhe dezinfektimin e ambjentit të punës;
- Të kontrollojë higjienizimin e tyre me teste të thjeshta të kontrollit të higjenes.

3. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtëjshëm në përfundim të arsimimit në profilin mësimor “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.

Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli IV arsimor, e pajis nxënësin me certifikatën e kontrollit laboratorik të ushqimit, , sipas nivelit IV të AP (nivelit V të KSHK). Ky kualifikim i jep nxënësit mundësi t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar apo vetëpunësuar në pozicionin e teknikut të laboratorit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore, në laboratorët e kontrollit të ushqimit (në industrinë e qumështit, mish-peshkut, pijeve alkoolike dhe jo-alkoolike, konservave të fruta-perimeve, trajtimit të ujërave, ushqimit për kafshë, të përgatitjes së brumërave, etj.), në laboratorë shtetërorë dhe privatë të Kontrollit Ushqimor , në laboratorë të doganave, në laboratorë shkencorë (laboratorë të Universiteteve që përfshin degët Kimi ushqimore, Teknologji ushqimore e Mikrobiologji). Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit të mëtëjshëm në arsimin e lartë, në degët e teknologjisë ushqimore dhe kimisë ushqimore.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, me kohëzgjatje 1 vit mësimor.

Plani mësimor për profilin mësimor “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK			
Nr	Kodi	Modulet mësimore	Orët mësimore
1	M-08-1052-14	Menaxhimi i laboratorit ushqimor	45
2	M-08-1053-14	Kuadri ligjor për laboratorin ushqimor	30
3	M-08-1054-14	Rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes së mjedisit në laboratorin ushqimor	30
4	M-08-1055-14	Analizat organo-shqisore të ushqimit	60
5	M-08-1056-14	Analizat e treguesve fizikë të ushqimit	90
6	M-08-1057-14	Analizat kimike të ushqimit	90
7	M-08-1058-14	Analizat mikrobiologjike të ushqimit	90
8	M-08-1059-14	Analizat e ujit të pijshëm	60
9	M-08-1060-14	Analizat e qumështit dhe nënprodukteve të tij	90
10	M-08-1061-14	Analizat e drithrave, miellrave dhe brumrave	60
11	M-08-1062-14	Analizat e konservave të fruta-perimeve	60
12	M-08-1063-14	Analizat e mishit dhe konservave të tij	60
13	M-08-1064-14	Analizat e peshkut dhe konservave të tij	60
14	M-08-1065-14	Analizat e pijeve alkoolike	60
15	M-08-1066-14	Analizat e pijeve joalkoolike	60
16	M-08-1067-14	Analizat e kafes, çajrave bimorë, kakaos dhe vezës)	60
17	M-08-1068-14	Analizat e ushqimeve për kafshë	45
		Gjithsej	1050

IV. Udhëzime për planin mësimor

Kohëzgjatja e vitit shkollor në arsimin profesional për “Kontroll laboratorik i ushqimit ” në nivelin V i KSHK, pas të mesmes, zgjat 1 vit mësimor, pra 35 javë mësimore (1050 orë mësimore) dhe 1 javë provimet përfundimtare.

Një javë mësimore ka 5 ditë/javë x 6 orë/ditë = 30 orë mësimore.

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, përbëhet nga modulet profesionale teoriko-praktike (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe. Renditja e realizimit të moduleve bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar parimet didaktike bazë (nga më e thjeshta te më e ndërlikuara, nga niveli i ulët te më i larti, nga teoria te praktika, etj.), si dhe kushte konkrete të shkollës. Për të rritur eficiencën e procesit mësimor, mund të realizohen paralelisht dy ose më shumë module, si dhe mund të zbatohet ndarja në grupe e nxënësve.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e moduleve profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin tek ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e moduleve profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të teorisë me praktikën në to, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.

Mësuesit duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës dhe punës. *Puna në grup* është një nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik dhe praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm në kualifikimin profesional “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK.

VI. Udhëzime për vlerësimin, provimet dhe certifikatën.

Vlerësimi vjetor i nxënësve për modulet profesionale bëhet nga vetë mësuesit përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) për modulet teoriko-praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të arsimimit për “Kontroll laboratorik i ushqimit”, niveli V i KSHK, pas të mesëm, nxënësit i nënshtrohen provimit teoriko – praktik i cili integron rezultatet mësimore të moduleve kryesore të këtij kualifikimi.

Në këtë provim ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohuri, shprehje, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale të profilit “Kontroll laboratorik i ushqimit”.

Me përfundimin e sukseshëm të shkollimit, nxënësit marrin Certifikatën përkatëse të aftësisë profesionale, e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MMSR, kjo dëshmi përmban:

- a) Të dhënat për nxënësin, ofruesin e kualifikimit, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.
- b) Të dhëna për rezultatet (notat) e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në modulet profesionale;
 - rezultatit e provimit përfundimtar.

1. Moduli “Menaxhim i laboratorit ushqimor

Profili: Kontroll laboratorik i ushqimit

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	MENAXHIM I LABORATORIT USHQIMOR	M-08-1052-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik-praktik që i njeh nxënësit me parimet dhe procedurat e menaxhimit të cilësisë në laboratorin ushqimor (LU), si dhe i aftëson ata që t’i zbatojnë këto parime dhe procedura gjatë veprimtarive të punës në laboratorin ushqimor.	
Kohëzgjatja e modulit	45 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në degën “Teknologji Ushqimore” niveli IV i KSHK. - Individë që janë të aftë nga pikëpamja shëndetsore për punë në sektorin e shërbimit laboratorik dhe përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - Individë që kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët kursi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësinë që ata shfaqin.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan konceptin e organizimit të laboratorit dhe kontrollit të cilësisë e sigurisë ushqimore. Përmbajtja: - Përshkrimi i konceptit të kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore. - Renditja e fazave të krijimit të një laboratorit ushqimor - Përshkrimi i strukturës organizative të një laboratorit ushqimor. - Renditja e detyrave dhe funksioneve të menaxherit të laboratorit, teknikut të laboratorit dhe stafit mbështetës. Instrumentet e vlerësimit: - Vëzhgim me listë kontrolli. - Pyetje përgjigje me gojë Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë saktë konceptin e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë ushqimore; - të rendisë saktë fazat e krijimit të një laboratorit ushqimor; - të përshkruajë strukturën organizative të një laboratorit ushqimor; - të rendisë detyrat dhe funksionet e menaxherit të laboratorit (ML), teknikut të laboratorit (TL) dhe stafit mbështetës në laboratorin ushqimor.	

RM 2 Nxënësi përshkruan organizimin e ambjenteve të laboratorit.

Përmbajtja:

- Organizimi i ambjenteve në një laborator ushqimor.
- Interpretimi i projektit të vendosjes së paisjeve dhe mjeteve në një laborator ushqimor.
- Listimi i aparateve kryesore në një laborator ushqimor.
- Listimi i instrumenteve të nevojshme në një laborator ushqimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë organizimin e ambjenteve në një LU;
- të interpretojë projektin e vendosjes së paisjeve dhe mjeteve në një laborator ushqimor, në funksion të analizës dhe sigurisë në punë;
- të listojë aparatet kryesore në një laborator ushqimor, duke cilësuar përdorimet e tyre përkatëse;
- të listojë instrumentet e nevojshme në një laborator ushqimor, duke cilësuar përdorimet e tyre përkatëse;

RM 3 Nxënësi përshkruan fazat e administrimit të laboratorit ushqimor.

Përmbajtja:

- Identifikimi i fazave të administrimit të një laborator ushqimor.
- Përshkrimi i procedurave për marrjen e mostrës.
- Përshkrimi i procedurës së pranimi dhe përgatitjes së mostrës për analizë.
- Përshkrimi i procedurës së kodimit të mostrës dhe shpërndarjes së tyre për analizë.
- Përshkrimi i procedurës së ruajtjes së mostrës.
- Përshkrimi i procedurës së trajtimit të mbetjeve laboratorike.
- Hartimi i listës së nevojave për blerjet në laborator.
- Hartimi i planit të mirëmbajtjes së paisjeve e mjeteve laboratorike.
- Hartimi i planit të trajnimit.
- Bashkëpunimi me sektorin e financës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë saktë, fazat e administrimit të një laborator;
- të përshkruajë saktë, procedurën e marrjes së mostrës;
- të përshkruajë saktë procedurën e pranimi dhe përgatitjes së mostrës për analizë.
- të përshkruajë saktë, procedurën e kodimit të mostrës dhe

- shpërndarjes së tyre për analizë;
- të përshkruajë, saktë, procedurën e ruajtjes së mostrës;
- të përshkruajë procedurën e trajtimit të mbetjeve laboratorike, në funksion të ruajtjes së ambientit;
- të hartojë listën e nevojave për blerjet në laborator, me specifikimet teknike të duhura;
- të hartojë planin e mirëmbajtjes së paisjeve dhe mjeteve laboratorike, sipas instruksioneve përkatese;
- të hartojë planin e trajnimit sipas nevojave që lindin, në përputhje me ndryshimet në laborator;
- të bashkëpunojë me sektorin e financës për llogaritjen e kostos së analizave laboratorike;

RM 4 Nxënësi përshkruan fazat e veprimit në laborator.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i fazave të punës në një LU.
- Interpretimi i planit të punës.
- Listimi i metodave standarte.
- Vlerësimi i metodave jo standarde të analizës.
- Përshkrimi i etapave të procedurës së kryerjes së analizës.
- Miratimi i rezultatit të analizës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë fazat e punës në një LU, për një koordinim sa më të mirë të tyre;
- të interpretojë saktë planin e punës në një LU;
- të listojë metodat standarde që përdoren në një LU, duke cilësuar përdorimet e tyre përkatese;
- të vlerësojë metodat jo standarte të analizës, duke u bazuar në metoda standarte;
- të përshkruajë saktë etapat e procedurës së kryerjes së analizës;
- të miratojë rezultatin e analizës, duke e interpretuar saktë atë;

RM 5 Nxënësi punon për sigurimin e cilësisë në laborator.

Përmbajtja:

- Përshkrimi i metodave të llogaritjes së saktësisë së analizës.
- Përshkrimi i standardeve të referencës.
- Interpretimi i qëllimit të përdorimit të mostrave standarde.
- Interpretimi i qëllimit të kryerjes së analizave paralele.
- Përshkrimi i detajeve të hartimit të një “raporti testimi”

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë saktë metodat e llogaritjes së saktësisë së

- analizës;
- të përshkruajë saktë standardet e referencës;
- të interpretojë qëllimin e përdorimit të mostrave standarde;
- të interpretojë qëllimin e kryerjes së analizave paralele, duke cilësuar rëndësinë e tyre;
- të përshkruajë saktë detajet e hartimit të një “raporti testimi”, konform kërkesave standarde.

RM 6 Nxënësi menaxhon jo konformitetet në laborator .

Përmbajtja:

- Menaxhimi i punës jo konforme në laborator.
- Analizimi i shkakut të punës jo konforme.
- Vlerësimi i punës jo konforme.
- Kryerja e veprimeve korrigjuese.
- Parashikimi i veprimeve parandaluese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të menaxhojë situatat e një pune jokonforme;
- të analizojë shkakun e punës jo konforme, duke u bazuar në procedurën e zhvilluar të testimit;
- të vlerësojë punën jo konforme, duke u bazuar në faktorët që ndikojnë në të;
- të kryerjë saktë veprime korrigjuese, gjatë punës në laborator;
- të parashikojë veprime parandaluese për fazën pasardhëse të testimit.

RM 7 Nxënësi zbaton procedurat standarde për dokumentacionin e laboratorit.

Përmbajtja:

- Listimi i dokumentacionit të laboratorit.
- Hartimi i dokumentacionit .
- Aprovimi i dokumentacionit.
- Plotesimi i dokumentacionit.
- Rishikimi dhe përmirësimi i dokumentacionit.
- Ruajtja e dokumentacionit.
- Zbatimi i procedurave të arkivimit të dokumentacionit të laboratorit ushqimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të listojë dokumentacionin e laboratorit, që është në përdorim;
- të hartojë dokumentacionin në çdo hallkë të procesit të menaxhimit;

- të njihet me procedurën e aprovimit të dokumentacionit, bazuar kjo në procedurat standarde të dokumentacionit;
- të plotësojë saktë dokumentacionin në çdo hallkë të procesit të menaxhimit;
- të rishikojë dhe përmirësojë dokumentacionin, bazuar në procedurat standarde të dokumentacionit;
- të ruajë dokumentacionin në hard disk dhe në formë të printuar;
- të zbatojë procedurat e arkivimit të dokumentacionit të laboratorit ushqimor.

RM 8 Nxënësi menaxhon shërbimet e blerjeve në laborator.

Përmbajtja:

- Sigurimi i kimikateve dhe reagentëve me cilësi.
- Parashikimi i blerjeve të paisjeve, kimikateve e reagentëve.
- Furnizimi me paisje dhe reagentë.
- Hartimi i formularit të porosisë së reagentëve dhe kimikateve të laboratorit ushqimor.
- Hartimi i formularit të kontrollit të hyrjeve në laboratorin ushqimor.
- Hartimi i formularit të inventarit të gjendjes së paisjeve, testeve, reagentëve e kimikateve në laboratorin ushqimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të sigurojë kimikateve dhe reagentëve me cilësi të tillë që të përmbushin standardet e metodikave me të cilat punohet;
- të parashikojë blerjet, për të mos lejuar mungesën e kimikateve dhe reagentëve në laborator;
- të kryejë furnizime me paisje e reagentë, nga firma të certifikuara;
- të hartojë formularin e porosisë së reagentëve dhe kimikateve të laboratorit ushqimor, mbi bazën e kërkesave të standartit ISO 17025 (Standarti për laboratorin);
- të hartojë formularin e kontrollit të hyrjeve në laborator, mbi bazën e kërkesave të standartit ISO 17025;
- të hartojë formularin e inventarit të gjendjes së testeve, reagentëve e kimikateve në laboratorin ushqimor.

RM 9 Nxënësi kryen kontrole të brendshme në laboratorin ushqimor.

Përmbajtja

- Përgatitja për kontrole të brendshme në laboratorin ushqimor.
- Miratimi i grupit të kontrollit.
- Kryerja e kontrollit të brendshëm.

- Raportimi i gjetjeve.
- Ndërmarrja e veprimeve korigjuese.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitet për kontrolle të brendëshme të laboratorit ushqimor
- të njihet me grupin e kontrollit të miratuar nga personi drejtues i laboratorit;
- të kryejë kontrollin e brendëshëm të laboratorit ushqimor mbi bazën e kërkesave standarde (17025);
- të raportojë gjetjet;
- të ndërmarrë veprime korigjuese.

RM 10 Nxënësi kryen rishikim të sistemit të cilësisë.

Përmbajtja

- Përgatitja për rishikimin e sistemit të cilësisë.
- Konfirmimi i pjesmarësve në rishikimin e sistemit të cilësisë nga personi drejtues i LU.
- Kryerja e rishikimit të sistemit të cilësisë.
- Hartimi i proces verbalit për situatën në LU.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje përgjigje me gojë ose me shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitet për rishikimin e sistemit të cilësisë;
- të konfirmojë pjesmarrësit në rishikimin e sistemit të cilësisë;
- të kryejë rishikimin e sistemit të cilësisë;
- të hartojë proces verbalin për situatën në LU;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë dhe më shumë në mjediset e laboratorit ushqimor.
- Mësuesi duhet të zbatojë sa më shumë shembuj dhe demonstrime të procedurave për menaxhimin e aspekteve të ndryshme të veprimtarive në laboratorin ushqimor, si dhe të plotësimit të dokumentacionit përkatës.
- Kursantët duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me konceptet dhe procedurat e menaxhimit të laboratorit ushqimor, si dhe në demonstrimin praktik të këtyre procedurave në laboratorin ushqimor.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer veprimtari menaxhuese në laboratorin ushqimor.
- Mësuesi duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin e normave dhe standardeve të cilësisë dhe të sigurisë, si dhe të nxitë punën në grup të nxënësve.

	- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kritereve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimi, të pasjisur si më poshtë: - Klasë mësimore dhe laborator ushqimor. - Tabela dhe pankarta ilustruese. - Pajisje, mjete dhe materiale laboratorike. - Dokumente dhe formularë që përdoren për aspektet e menaxhimit në laborator ushqimor. - Dokumente të rregulloreve, normave dhe standardeve për veprimet laboratorike. - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli "Kuatrli ligjor për laboratorin ushqimor".

Profili: Kontroll laboratorik i ushqimit

Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	KUADRI LIGJOR PËR LABORATORIN USHQIMOR	M-08-1053-14
Qëllimi i modulit	Një modul teorik që aftëson nxënësit me zotërimin e nocioneve kryesore të kuadrit ligjor bazë për ushqimin, që vepron në laboratorin ushqimor.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në degën "Teknologji Ushqimore" niveli IV i KSHK. - Individë që janë të aftë nga pikëpamja shëndetsore për punë në sektorin e shërbimit laboratorik dhe përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - Individë që kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët kursi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësinë që ata shfaqin.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi zbaton kërkesat e ligjit të ushqimit në laboratorin ushqimor. Përmbajtja: - Shpjegimi i rolit dhe rëndësisë së ligjit të ushqimit. - Njohja e dispozitave të përgjithshme të kuadrit ligjor të kontrollit të ushqimit. - Njohja e kërkesave të përgjithshme të kontrollit mbi sigurinë ushqimore. - Përkufizimi i kuptimit të ushqimit të sigurtë dhe cilësor. - Shpjegimi i bar kodit të ushqimi - Njohja me direktivat e Bashkimit Europian (BE), për sigurinë ushqimore. - Njohja e rolit të analizës së produktit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e ligjit të ushqimit; - të njohë dispozitat e përgjithshme të kuadrit ligjor të kontrollit të ushqimit; - të njohë kërkesat e përgjithshme të kontrollit mbi sigurinë ushqimore; - të përkufizojë kuptimin e ushqimit të sigurtë dhe cilësor; - të shpjegojë bar kodin e ushqimit, mbi bazën e kërkesave standarde; - të njohë direktivat e BE për sigurinë ushqimore.	

-
- të njohë rolin e analizës së produktit në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit.

RM2 Nxënësi zbaton kërkesat e ligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Përmbajtja:

- Njohja me kuadrin ligjor për mbrojtjen e interesave të konsumatorit.
- Njohja me kërkesat e përgjithshme të etiketimit të produktit.
- Njohja me rëndësinë e vendosjes së datës së skadencës dhe prodhimit të produktit.
- Njohja me përkufizimet dhe klasifikimet e përbërësve të produktit që analizohet.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të njohë kuadrin ligjor për mbrojtjen e interesave të konsumatorit;
- të njohë kërkesat e përgjithshme të etiketimit të produktit si mjet informues në shërbim të konsumatorit;
- të njohë rëndësinë e vendosjes së datës së skadencës dhe prodhimit të produktit, në funksion të mbrojtjes së konsumatorit;
- të njohë përkufizimet dhe klasifikimet e përbërësve të produktit që analizohet, për të evidentuar fallsifikimet e mundëshme;

RM 3 Nxënësi përshkruan rolin e Kontrollit Zyrtar të Ushqimit.

Përmbajtja:

- Njohja e strukturave të kontrollit zyrtar të ushqimeve.
- Njohja e funksioneve të strukturave përkatëse të kontrollit të ushqimeve.
- Njohja e rolit të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit (A.K.U).
- Njohja e rolit të funksionit të organizatës EFSA. (European Food Safety Authority) Autoriteti European i Sigurisë Ushqimore.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të njohë strukturat e kontrollit zyrtar të ushqimeve;
- të njohë funksionet e strukturave përkatëse të kontrollit të ushqimeve;
- të njohë rolin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, në garantimin e sigurisë dhe cilësisë së produktit ushqimor në të gjitha fazat e prodhimit.

- të njohë rolin e funksionit të organizatës EFSA, garantimin e sigorisë ushqimore europiane.

RM 4 Nxënësi zbaton kërkesat e Standarteve të Ushqimit gjatë punës në laborator .

Përmbajtja:

- Përshkrimi i standarteve shtetërore të detyrueshme në fushën e ushqimit.
- Përshkrimi i rendësisë së standardeve në interpretimin e rezultatit të analizës.
- Përshkrimi i mënyrës standarde të paraqitjes së raportit të testimit.
- Përshkrimi i rolit të kontrollit laboratorik të ushqimit..

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje-përgjigje me gojë dhe me shkrim.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë standardet shtetërore të detyrueshme në fushën e ushqimit;
- të përshkruajë rëndësinë e standardeve në interpretimin e rezultatit të analizës;
- të përshkruajë mënyrën standarde të paraqitjes së raportit të testimit;
- të përshkruajë rolin e kontrollit laboratorik të ushqimit në zbatimin e standardeve të ushqimit në gjithë zinxhirin prodhues.

Udhëzime për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e nxënësve.

Ky modul duhet të trajtohet në klasë.

- Mësuesi duhet të demonstrojë praktikisht të gjitha njohuritë dhe hallkat e procesit analitik të masave të sigurisë dhe të mbrojtjes së ushqimit në pajtueshmëri me standardet e sigurisë ushqimore.
- Nxënësi duhet të angazhohet në veprimtari konkrete në zbatimin e ligjeve në përputhje me zhvillimin e realiteteve të reja, në aftësimin e tyre për jetën.
- Mësuesi duhet të organizojë punën me metoda të ndryshme mësimnxënie, ku nxënësit kryejnë interpretime të ligjeve dhe të standarteve në përputhje me situata konkrete.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, të vihet theksi në arritjet e sjelljeve shprehive dhe aftësive të cilat nxënësi të menduarit kritik dhe krijues.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të punohet praktikisht dhe të sigurohen mjediset, mjete dhe materialet e mëposhtme:

- Në një laborator ushqimor ose në një organ të kontrollit të ushqimit.
- Kompleti i ligjeve të ruajtjes së ushqimit dhe mjedisit, kuptimi i ushqimit të sigurtë dhe të përshtatshëm ,aplikimit të përgjithshëm i kërkesave të sigurisë së ushqimit si dhe Pajtueshmëria me kërkesat e sigurisë ushqimore.

-
- Paisje teknologjike që shërbejnë për mësimdhënie.
 - Manuale, udhëzuesa, katalogë, rregullore standarte në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3.Moduli “Rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes së mjedisit në laboratorin ushqimor”

Profili: Kontroll laboratorik i ushqimit
Niveli: V i KSHK

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK E MBROJTJES SË MJEDISIT NË LABORATORIN USHQIMOR	M-08-1054-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i njeh nxënësit me rregulla e sigurimit teknik në laboratorin ushqimor, rregullat e sigurisë për shmangien e rreziqeve në punë, rregulloren e punës dhe zbatimin e saj, si dhe rregullat për mbrojtjen e mjedisit, duke i aftësuar ata të zbatojnë këto norma dhe standarde gjatë veprimeve në laboratorin ushqimor.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në degën “Teknologji Ushqimore”niveli IV i KSHK. - Individë që janë të aftë nga pikëpamja shëndetsore për punë në sektorin e shërbimit laboratorik dhe përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - Individë që kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët kursi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësinë që ata shfaqin.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1	Nxënësi zbaton rregullat e sigurimit teknik gjatë punës në laborator. Përmbajtja: - Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik në laboratorin ushqimor. - Hartimi i rregulloreve të sigurimit teknik në laboratorin ushqimor. - Hartimi i tabelave instruktuese. - Zbatimi i tabelave instruktuese. - Dhënia e ndihmës së parë në rastet e nevojshme. - Përdorimi i stacionit të emergjences për larjen e syve. - Përdorimi i stacionit të emergjences në rastin e djegjeve të jashtme - Garantimi i izolimit të paisjeve nën presion. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje – përgjigje me gojë dhe me shkrim - Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik në laboratorin ushqimor;

-
- të hartojë rregulloret e sigurimit teknik sipas specifikave të aparaturave , paisjeve dhe reagenteve kimike në laboratorin ushqimor;
 - të hartojë tabelat instruktuese sipas instruksioneve të aparateve;
 - të zbatojë tabelat instruktuese të aparateve e paisjeve;
 - të japë ndihmën e parë në rastet e nevojshme, duke përdorur paketën e ndihmës së shpejtë.
 - të përdorë, si duhet, stacionin e emergjences për larjen e syve;
 - të përdorë, si duhet, stacionin e emergjencës në rastin e djegjeve të jashtme;
 - të garantojë izolimin e paisjeve nën presion, sipas të dhenave në instruksionet e aparateve;

RM 2 Nxënësi zbaton rregullat e sigurisë për shmangien e rreziqeve në laborator.

Përmbajtja:

- Listimi i llojeve të rreziqeve në një LU.
- Zbatimi i rregullave për mbrojtjen nga rreziqet fizike.
- Zbatimi i rregullave për mbrojtjen nga rreziqet kimike.
- Zbatimi i rregullave për mbrojtjen nga rreziqet mikrobiologjike.
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe korenti.
- Sigurimi i hapësirave të lira të nevojshme për rastet e rreziqeve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të listojë llojet e rreziqeve në një laborator ushqimor;
- të zbatojë drejt rregullat specifike, për mbrojtjen nga rreziqet fizike;
- të zbatojë drejt rregullat specifike, për mbrojtjen nga rreziqet kimike;
- të zbatojë drejt rregullat specifike, për mbrojtjen nga rreziqet mikrobiologjike;
- të zbatojë drejt rregullat specifike, për mbrojtjes nga zjarri dhe korenti;
- të sigurojë hapësirat e lira, të nevojshme për rastet e rreziqeve sipas standarte për ndertimin e laboratoreve;

RM 3 Nxënësi zbaton rregullat e punës në laboratorin ushqimor.

Përmbajtja:

- Zbatimi i rregulloreve të punës në një laborator ushqimor.
- Përdorimi i pajisjeve dhe mjeteve për mbrojtjen individuale.
- Zbatimi i rregullave të punës në laboratorin fiziko kimik.
- Zbatimi i rregullave të punës në laboratorin

mikrobiologjik.

- Përshkrimi i rëndësisë së zbatimit të rregullores së punës në një laborator ushqimor.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të zbatojë rregulloren e punës në një laborator ushqimor;
- të përdorë pajisjet dhe mjetet e mbrojtjes individuale sipas rregullave për mbrojtjen në punë;
- të zbatojë rregullat specifike të punës në laboratorin fiziko-kimik;
- të zbatojë rregullat specifike të punës në laboratorin mikrobiologjik;
- të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullores së punës në një laborator ushqimor;

RM 4 Nxënësi zbaton rregullat për mbrojtjen e mjedisit.

Përmbajtja:

- Mbrojtja e mjedisit.
- Listimi i llojeve të mbetjeve në një laborator ushqimor..
- Zbatimi i procedurave standarte për trajtimin e mbetjeve laboratorike.
- Marrja e masave për mbrojtjen e mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë ose me shkrim
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të mbrojë mjedisin nga mbetjet laboratorike;
- të listojë llojet e mbetjeve në një laborator ushqimor;
- të zbatojë procedurat standarde për trajtimin e mbetjeve laboratorike, në fuksion të ruajtjes së mjedisit;
- të marrë masat për mbrojtjen e mjedisit, gjatë punës në laboratorin ushqimor;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të zhvillohet në klasë dhe më shumë në mjediset e laboratorit ushqimor.
- Mësuesi duhet të japë sa më shumë shembuj dhe ilustrime të koncepteve dhe parametrave të cilësisë, saktësisë dhe sigurisë si dhe të normave dhe standardeve përkatëse, si dhe të demonstrojë procedura laboratorike në përputhje me këto norma e standarde.
- Nxënësit duhet të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur në diskutimet në lidhje me konceptet dhe parametrat e sigurisë, saktësisë dhe cilësisë, si dhe me normat dhe standardet përkatëse, si dhe të kryejnë procedura laboratorike në përputhje me këto norma e standarde.

	- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të synohet më tepër në verifikimin e shkallës së aftësive praktike që ata kanë fituar për të kryer veprime dhe llogaritje statistikore që lidhen me veprimtarinë e punës në laborator ushqimor. - Mësuesi duhet të kërkojë me rreptësi zbatimin e normave dhe standardeve të cilësisë dhe të sigurisë. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet plotësimi nga nxënësi i të gjitha kriterëve të realizimit të çdo rezultati mësimor të modulit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e mësimin, të pasjisur si më poshtë: - Klasë mësimore dhe laborator ushqimor. - Tabela dhe pankarta ilustruese. - Pajisje dhe mjete laboratorike. - Kimikate dhe materiale të tjera laboratorike. - Dokumente të normave dhe standardeve për veprimet laboratorike. - Rregullore të cilësisë dhe sigurisë në laboratorët ushqimorë. - Materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

4. Moduli “Analizat organo-shqisore të ushqimit”

Profili: Kontroll laboratorik i ushqimit

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ANALIZAT ORGANO-SHQISORE TË USHQIMIT	M-08-1055-14
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që aftëson nxënësit për identifikimin, dallimin, shpjegimin dhe përshkrimin e vlerësimit të treguesve organoshqisore të produkteve ushqimore, si gjëndja fizike, pamja e jashtme, ngjyra, era dhe shija.	
Kohëzgjatja e modulit	60 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	- Individë që kanë përfunduar arsimin e mesëm profesional në degën “Teknologji Ushqimore” niveli IV i KSHK. - Individë që janë të aftë nga pikëpamja shëndetsore për punë në sektorin e shërbimit laboratorik dhe përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional. - Individë që kanë aftësi të kufizuara, por për të cilët kursi krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësinë që ata shfaqin.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përshkruan metodat e realizimit të analizave organo-shqisore, sipas llojit të produktit. Përmbajtja: - Identifikimi i treguesve organo-shqisore dhe i vlerave ndjesore. - Dallimi i veçorive të treguesve organo-shqisore të ushqimit. - Analizimi i ndikimit të faktorëve ndjesorë dhe të jashtëm në degustimin e ushqimit. - Shpjegimi i rëndësisë së kontrollit të ambalazhimit dhe marketimit të produktit. - Përshkrimi i metodave për përcaktimin e treguesve organo-shqisore. - Përshkrimi i përgatitjes së raport provës. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje-përgjigje me gojë ose me shkrim. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë treguesit organo-shqisore dhe vlerat ndjesore në lidhje me ushqimin; - të dallojë veçoritë e treguesve organo-shqisore të ushqimit, sipas llojit të produktit; - të analizojë ndikimin e faktorëve ndjesorë dhe të jashtëm	

-
- në degustimin e ushqimit;
 - të shpjegojë rëndësinë e kontrollit të ambalazhimit dhe paketimit;
 - të përshkruajë metodat për përcaktimin e treguesve organo-shqisorë;
 - të përshkruajë përgatitjen e raport -testit laboratorike.

RM 2 Nxënësi parapërgatit kushtet për kryerjen e analizave organo shqisore të ushqimit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e laboratorit për punë.
- Zbatimi i rregullores së punës në laborator.
- Kontrolli i gjendjes teknike të aparaturave dhe i parametrave optimalë të laboratorit.
- Përshkrimi i teknikës për marrjen dhe përgatitjen e mostrës mesatare për produkte të ndryshme.
- Përzgjedhja e kriterëve të marrjes së mostrës për analizë dhe mostrës standarde (krahasuese)
- Marrja dhe përgatitja e mostrës mesatare.
- Përgatitja e raport-testimit laboratorik.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.
- Pyetje-përgjigje me gojë

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë laboratorin për punë;
- të zbatojë rregulloren e punës në laboratorin ushqimor;
- të kryejë kontrollin e temperaturës, lagështisë relative dhe aparaturave, konform kërkesave standarde (17025) për ambientet laboratorike;
- të përshkruajë teknikën për marrjen dhe përgatitjen e mostrës mesatare për produkte të ndryshme (metodave standardeve);
- të përzgjedhë drejt kriteret e marrjes së mostrës për analizë dhe mostrës standarde (krahasuese) sipas procedurës;
- të kryejë marrjen dhe përgatitjen e mostrës mesatare;
- të përgatitë raportin e testimit, sipas kërkesave standarde.

RM 3 Nxënësi kryen analizat organo-shqisore të ushqimit.

Përmbajtja:

- Përgatitja e laboratorit për punë.
- Zbatimi i rregullores së punës në laboratorin ushqimor.
- Kontrolli i temperaturës, lagështisë relative dhe aparaturave në ambientet laboratorike.
- Përzgjedhja e metodikës së analizës.
- Përgatitja e mjeteve ndihmëse për kryerjen e analizave organo-shqisore.
- Përgatitja e mostrës për analizë dhe mostrës standarde (krahasuese).

- Kryerja e analizës për përcaktimin e pamjes.
- Kryerja e analizës për përcaktimin e ngjyrës.
- Kryerja e analizës për përcaktimin e kthjelltësisë.
- Kryerja e analizës për përcaktimin e aromës.
- Kryerja e analizës për përcaktimin e shijes.
- Kryerja e analizës për përcaktimin e strukturës (konsistencës).
- Kryerja e vlerësimit të ambalazhimit dhe parketimit.
- Vlerësimi organo-shqisor i ushqimit me sistem pikësh.
- Regjistrimi i rezultateve të analizave.
- Krahësimi i rezultateve të analizave me treguesit e etiketimit të produktit ushqimor.
- Interpretimi i rezultateve të analizave.
- Raportimi i analizave të kryera.
- Plotësimi i raportit të testimit.
- Pastrimi i vendit dhe mjeteve të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje-përgjigje me gojë

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë laboratorin për punë;
- të zbatojë rregulloren e punës në laboratorin ushqimor;
- të kryejë kontrollin e temperaturës, lagështisë relative dhe aparaturave, konform kërkesave standarde (17025) për ambjentet laboratorike;
- të përzgjedhë metodikën e analizës sipas llojit të treguesit;
- të përgatisë mjetet ndihmëse për kryerjen e analizave organo-shqisore;
- të përgatisë mostrën për analizë dhe mostrën standarde (krahësuese);
- të kryejë analizën për përcaktimin e pamjes; duke zbatuar me saktësi metodikën;
- të kryejë analizën për përcaktimin e ngjyrës duke zbatuar me saktësi metodikën;
- të kryejë analizën për përcaktimin e kthjelltësisë (për produktet me konsistencë të lëngët duke zbatuar me saktësi metodikën;
- të kryejë analizën për përcaktimin e aromës duke zbatuar me saktësi metodikën;
- të kryejë analizën për përcaktimin e shijes duke zbatuar me saktësi metodikën;
- të kryejë vlerësimin e ambalazhimit dhe parketimit;
- të kryejë vlerësimin organoshqisor me sistem pikësh;
- të regjistrojë rezultatet e analizave në regjistrat e laboratorit;
- të krahasojë rezultatet e analizave me treguesit e

- etiketimit të produktit ushqimor;
- të interpretojë rezultatet e analizave, bazuar në standartet përkatëse;
- të raportojë tek menaxheri i laboratorit për analizat e kryera;
- të plotësojë raportin e testimit, sipas normave standarte;
- të pastrojë vendin dhe mjetet e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, gjatë analizave organo-shqisore.

Udhëzime për zbatimin e modulit	Ky modul duhet të zhvillohet në laborator - Laboranti instruktues, specialisti kimist-ushqimor i laboratorit duhet të shpjegojë dhe të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime të zhvillimit të analizave organo-shqisore të ushqimit - Kursantët duhet të shpjegojnë, përshkruajnë, dallojnë dhe të angazhohen në veprimtari konkrete eksperimentale për kryerjen e analizave organo-shqisore të produkteve ushqimore - Laboranti instruktues ose specialisti kimist-ushqimor duhet të mbikqyrë respektimin e rregullave të sigurisë dhe mjedisore. - Gjatë vlerësimit të kursantëve, duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive teorike dhe praktike për kryerjen e analizave organo-shqisore të ushqimit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjedise të përshtatshme për zhvillimin e analizave organo-shqisore, dhe materiale ndihmëse si më poshtë: - Laborator të ndriçuar mirë. - Mjete pune laboratorike për kryerjen e analizave organo-shqisore (qelqurina ,epruveta, cilindra, gota kimike, gota specifike degustimi, ujë i distiluar, qirinj, mostra standarde, etj) - Mostra të ndryshme (lëndë të para dhe produkte përfundimtare). - Pankarta, letra të bardha (tabakë), neone, udhëzues, katalogë, rregullore, etj.

5. Moduli “Analizat e treguesve fizikë të ushqimit”

Profili: Kontroll laboratorik i ushqimit

Niveli: V i KSHK

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	ANALIZAT E TREGUESVE FIZIKË TË USHQIMIT	M-08-1056-14
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer matje të parametrave fizikë të ushqimeve, si temperaturën, dendësinë, rritjen e vëllimit, presionin i gazit , lagështinë, raportin produkt-leng, lenda e thatë etj.	
Kohëzgjatja e modulit	90 orë mësimore	
